

## **Departamenti i Auditimit të Institucioneve Qëndrore dhe Departamenti i Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja zhvilluan në Universitetin “Fan S. Noli” të qytetit të Korçës, workshop-in “Planifikimi i veprimtarisë audituese për vitin 2025”**

Në datat 29-30 tetor, Departamenti i Auditimit të Institucioneve Qëndrore dhe Departamenti i Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja zhvilluan në Universitetin “Fan S. Noli”, workshop-in “Planifikimi i veprimtarisë audituese për vitin 2025”.

Në aktivitet morën pjesë Drejtori i Përgjithshëm i KLSH-së znj. Mariola Llanaj, drejtues të departamenteve të auditimit në KLSH dhe audituesit e Departamenteve përkatëse.

Aktiviteti u përshendet nga Rektori i Universitetit “Fan S. Noli” Prof. Dr. Lenci Ekonomi dhe Dekani i Fakultetit të Ekonomisë Prof. As. Dr. Ledina Aliolli. Pjesëmarrës në këtë aktivitet ishin edhe student të cilët u inkurajuan për një pjesëmarrje aktive si dhe dhënien e mendimeve mbi perceptimin e tyre për problematikat e realitetit.



Fjalën e hapjes së këtij aktiviteti e mbajti Drejtoresha e Përgjithshme e cila theksoi rëndësinë e procesit të planifikimit në përmbushjen e misionit kushtetues. Ajo theksoi rëndësinë e metodologjisë së re, e cila është krijuar duke u orientuar drejt problemeve sociale dhe reale të vendit. Me rëndësi të veçantë është dëgjesa e zërit të padëgjuar të studentëve dhe transmetimi i tij në Parlament, por dhe bashkëpunimi me institucionet e arsimit të lartë në vend.

Rektori i Universitetit falenderoi për përzgjedhjen e Universitetit të Korçës si dhe u shpreh rreth besimit të krijuar nga njerëzit për institucionin e Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Prof. As. Dr. Ledina Aliolli, Dekan i Fakultetit të Ekonomisë, shprehu vlerësimin maksimal për punën e KLSH-së si një institucion prestigjioz që ka të bëjë më orientimin e drejtë të fondeve si dhe duke shërbyer si skaneri i të vërtetës së pa kontestueshme.

Aktiviteti vijoi me prezantimet e Drejtorëve të Departamenteve të Auditimit ku u theksua se ka një traditë për procesin e planifikimit, ku çdo departament sipas axhendave përcakton pikat kryesore në një draft plan për vitin pasardhës, i cili bëhet detyrim pas miratimit nga Kryetari i KLSH-së dhe për efekt të transparencës publikohet në faqen zyrtare të KLSH-së.

Në përfundim u vijua me propozimet individuale të audituesve si dhe rezultatet e dala nga zhvillimi i metodologjisë dhe analiza e riskut. Në fund të aktivitetit u shkëmbyen idetë për subjektet që duhen të përfshihen në planin vjetor të auditimeve për vitin 2025.